

Udhëzim për planifikimin e mësimit në Shkencat natyrore për klasën e I -rë

Skema për punë – shkencat natyrore

Klasa e I-rë

Hyrje

Dokumenti paraqet skemën, pikërisht planin e punës së programit mësimor për shkencat natyrore për klasën e parë.

Qëllimet mësimore janë të grupuara në tema pikërisht njësi për mësim në gjysmëvjetorin e parë.
Renditjen e realizimit të temave mund ta ndërroni në përputhje me kushtet dhe disponimin e resurseve.

Udhëzimi bazohet në 16 javë pune në gjysmëvjetorin e parë.

Qëllimet që bazohen në hulumtime shkencore përsëriten, ose shfaqen në secilën njësi mësimore dhe shfletohen në pjesën e parë të njësisë mësimore

Më pas vijojnë qëllimet mësimore të cilat kanë për bazë temat dhe njësinë konkrete.
Qëllimet janë të shoqëruara me aktivitete dhe resurse adekuate(materiale dhe mjete) për ti paraqitur mënyrën e realizimit

| |
|----------------------------------|
| Gjysmëvjetori i parë |
| Njësia 1.1 Ne |
| Njësia1.2 Prej çfarë është bërë? |
| Njësia1.3 Zhvillimi dhe rritja |

Njësia:1.1 Ne

Në këtë temë nxënësit mësojnë se njerëzit dhe gjallesat tjera lëvizin dhe rriten

Ato gjithashtu mësojnë për shqisat e tyre dhe si ato ti përdorin për hulumtimin e botës rreth tyre.

Hulumtimet shkencore fokusohen në:

- vëzhgim dhe përshkrim të qenieve të gjalla dhe shqyrtim rreth asaj se çfarë ndodh
- hulumtim dhe shfrytëzim të kujtesës
- mundësi e të menduarit për atë se sa me përkujdes duhet të silltet ndaj qenieve të tjera të gjalla

| Qëllimet e mësimit | Nocionet |
|---|---|
| <p>Fakte dhe ide - përqipet të përgjigjet në pyetjen e cila përfshin fakte nëpër mjet të vëzhgimit.</p> <p>Planifikim të punës hulumtuese - parashtron pyetje dhe është aktiv në diskutim për të arritur deri në përgjigje - parashikon - vendos se çfarë duhet bërë për tu përgjigju në pyetjen shkencore.</p> <p>Fitimin dhe parashikim të fakteve - Hulumtime, vëzhgime dhe mbledhje të fakteve (matje dhe vëzhgim) për tu përgjigjur në pyetjen. - parashtron mendime dhe ndjek udhëzimet - evidenton etapat e punës</p> <p>Rishikim të qasjes dhe fakteve - bën krahasime -krahason parashikimet me fitimin e rezultateve të fituara - krijon ide dhe diskuton për ato me qëllim të bëj krahasim, sqarim dhe zhvillim.</p> | <p>njeri gjallesë lëvizje zhvillim shqisa – shikimi, prekja/ ndjenjat,shije, aromë, dëgjim. Koka – sytë. veshët, hunda, buzë, flokë trupi dora -supet këmba-gjunjë këmba – gishtat e këmbës</p> <p>Hulumtimi shkencor Qëllon (parashikon) krahason</p> |

| Qëllimet e mësimit | Aktivitetet | Resurse(mjete dhe materiale) | Koncepte |
|---|---|--|---|
| <p>Biologji (njerëzit dhe qeniet e gjalla)</p> | | | |
| <p><u>Java e parë dhe e dytë (3 orë)</u>Njeh dallimet dhe ngjashmëritë në mes secilit prej tyre.</p> <p><u>Hulumtim shkencor</u> Ide dhe fakte Përpiqet të përgjigjet në pyetjet me mbledhjen e fakteve duke hulumtuar.</p> <p>Fitimin dhe parashikimin e fakteve Hulumtim dhe vëzhgim (matje dhe vëzhgim) që të përgjigjet në pyetjen.</p> <p>Rishikim të fakteve dhe qasjes Bën krahasime.</p> | <p><u>Ora e 1: Në çka jemi të ngjajshëm?</u> Loja:Luteni nxënësit të synojnë/ tregojnë ndryshimin e trupit të tyre. p.sh. ta prekin kokën e tyre. veshët, hundën, gjunjët etj.</p> <p>Parashtroni disa pyetje të llojit: „Sa ...?“, p.sh. „ Sa gishtërinj ke? “. Përsëritni pyetjen për pjesë të ndryshme të trupit.</p> <p>Këndoni këngë në të cilën kërkohet nga ato të vërejnë ndryshimin e jashtëm të karakteristikave trupore. Ndiqni faqen e internetit nga kolona me resurse →</p> <p>Paraqite fjalën krahasim. Në çifte nxënësit bisedojnë për diçka për të cilat janë të ngjajshme / të njëjta. Diskutoni rreth përgjigjeve në grup, si klasë. Shënioni me listë në flipçart ose në tabelë të bardhë, p.sh e njëjtë është: 2 sy, 2 këmbë/shputa, trupi, koka etj.</p> <p>Secilit nxënës i jepni pasqyrë. Shfrytëzoni këtë që të vizatojnë veten e vetë, . Luteni të tregojnë dhe ti emërojnë pjesët nga trupi.</p> <p><u>Ora e 2: Në çka jemi të ndryshueshëm?</u> Filloni orën me pyetjet për atë se në çka jemi të ngjajshëm (me qëllim që të bëhet përmbledhja e asaj se çfarë është mësuar në orën e kaluar). Edhe një herë këndoni këngën nga njësia mësimore e kaluar ose këndoni këngë të re.</p> | <p>Teksti dhe muzika për këngën në të cilën tregohen ndryshimet e pjesëve trupore. Kënga Kjo jam unë http://youtu.be/OkHO0CYwjaI</p> <p>flipçart dhe markera ose tabel e bardhë interaktive</p> <p>pasqyrë(plastike), lapsa, letër për vizatim</p> <p>Për ide më të shumta shihni në http://www.elflearning.jp</p> | <p>Shprehjet themelore/ nocione prekje orientim koka-sy, veshë, hunda, buzë, mjekra, dhëmbë flokë trupi- qafa, shpina, stomaku, duart – shpatullat, bërryli, duart, gishtërinj këmbë- gjunjë,shputat ,gishtat e këmbës</p> <p>Hulumtimi shkencor sheh krahason e njëjtë</p> <p>Nëse pasqyrat janë prej qelqi, atëher skajet e pasqyrës duhet të ngjiten me trak për mbrojtje</p> <p>Shprehjet themelore- si më lartë dhe E ndryshme</p> <p>Gjithmonë shikoje këngën para se ta lëshoni në klasë. Disa prej tyre mund të jenë në gjuhën në të cilën nuk është e kuptueshme për ju</p> |

| Qëllimet e mësimit | Aktivitetet | Resurse(mjete dhe materiale) | Koncepte |
|---|---|---|---|
| Biologji (njerëzit dhe qeniet e gjalla) | | | |
| <p>Njeh dallime dhe ngjashmëri në mes secilit prej tyre.</p> <p>Hulumtime shkencore</p> <p>Planifikim për punë hulumtuese</p> <p>Parashikon.</p> <p>Vendos se çfarë do të bëjë për tu përgjigjur në pyetjen e mësuar.</p> | <p>Nxënësit në çifte bisedojnë për dallimet që i kanë njëri me tjetrin . Më pas i tregojnë përgjigjet e tyre. Mësimdhënësi i shënon në flipçart ose tabelë. Jepni kurajë nxënësve që të „përpiqen“ ti shënojnë fjalitë të cilat tregojnë (ose ta njih shkronjën e parë ose zërin)</p> <p>Më parë përgatitni materialet e nevojshme për lojën me fotografi: formoni disa grupe me fotografi ose fotografi digjitale të fëmijëve. Vendosni fotografit në tavolinë me fytyrën e kthyer poshtë.</p> <p>Nxënësit duhet të zgjedhin 2; nëse janë të ndryshme, ato do ti mbajë. Nëse fotografit janë të njejta, ato përsëri do ti kthejë në tavolinë me fytyrë të kthyer poshtë.</p> <p>Fitues do të jetë nxënësi i cili në fund do të ketë më shumë çifte të fotografive</p> <p>Mundësi, bëni kolazh nga fytyra e tyre në pjatë prej letre. Lusni që të va tregojnë ose tu tregojnë për cilën do prej karakteristikave.</p> <p><u>Java e dytë: Ora e 3 Kush është më i gjatë?</u></p> <p>Pa biseduar nxënësit duhet të renditen në vijë nga më i shkurtri deri te më i gjati. Bëni fotografi digjitale të grupit. Me ndihmën e fotografisë nxënësit vërejnë se a është e nevojshme të bëjnë ndonjë ndryshim në renditje.</p> <p>Nxënësit më i gjatë dhe më i shkurtër qëndrojnë njëri ndaj tjetrit. Nga nxënësit tjerë kërkohet të vlersojnë se sa është ndryshimi në mes nxënësve në centimetra</p> | <p>Grupe fotografish nga fëmijët ose fotografi digjitale nga nxënësit e paraleles.</p> <p>pjata prej letre letër me ngjyra flamosterë për pëlhurë lapsa rruaza, toka, zbukuruese, pupla</p> <p>letër me ngjyra, flamostera për qëndisje, rrota, kopsa, lidhëse, pupla</p> <p>Kamerë digjitale</p> | <p>Kolazh Preje Ngjite</p> <p>Shprehje kryesore/nocione i gjatë/më i gjatë i shkurtër/më i shkurtër përqindje parashiko centimetra gjatësi njësi trakë matëse vizore</p> |

| Qëllimet e mësimit | Aktivitetet | Resurse(mjete dhe materiale) | Koncepte |
|--|--|---|---|
| Biologji (njerëzit dhe qeniet e gjalla) | | | |
| | <p>Organizoni nxënësit në grupe me nga 6 nxënës. Lusni që ta shënojnë emrin e nxënësit më të gjatë në grup dhe ta vlerësojnë gjatësinë me centimetra. Pason diskutimi për atë se si mund të matet gjatësia. Në kuadër të grupit të tyre nxënësit duhet të masin gjatësinë e secilit anëtar të grupit . Matjet e fituara duhet ti shënojnë në fletat e punës. Pyeteni nxënësit të tregojnë se çfarë zbuluan – cili është më i gjati? Si e mësuan atë? Tregoni ndryshimin në gjatësi në mes anëtarëve më të shkurtër dhe më të gjatë të grupit ose klasës.</p> | <p>laps shufra matëse vizore barometër kuadra lidhëse</p> | <p>lidhëse kuadra vërejtje ndryshimi</p> <p>Hulumtime shkencore Sheh Qëllon(parashikon) krahason disa nxënës kanë aftësi të masin me zbatim të mjeteve për matje të standardizuara(me ndihmën e të rriturit); të tjerëve do t’ju nevojitet mjete jo të standardizuara për matje; (sigurojuni mjete për matje të shumëllojshme që të zgjedhin nga ato)</p> |

| | | | |
|--|--|---|---|
| <p>Java e 2 Njihi dhe emëroj pjesët e jashtme kryesore të trupit.</p> <p>Hulumtim shkencor Fakte dhe ideja Përpiqet të përgjigjet në pyetjet me mbledhjen e fakteve nëpërmjet të vëzhgimit.</p> <p>Rishikim i fakteve dhe qasja Bëj krahasime.</p> | <p>Ora e 4: Emërimi i pjesëve të trupit(1) Përsërit ndonjë këngë nga njësit e mëparshme (të cilat kujtojnë emërimet e pjesëve të trupit).</p> <p>Realizoni lojën „Sajmoni thotë“. Dëgjoni dhe ndiqeni rregullat e lojës. Ushtroni lojën disa herë për deri sa nxënësit të kuptojnë se çfarë duhet të bëjnë . Nxënësit dalin nga loja në qoftë se bëjnë gabim ose nëse mbesin të fundit në realizimin e udhëzimeve.</p> <p>Shpërndani nga një pasqyrë secilit nxënës dhe lusni ta shohin fytyrën e tyre në pasqyrë. Nxënësit i emërojnë dhe përcaktojnë pjesët në kokën e tyre.</p> | <p>http://en.wikipedia.org/wiki/Simon_says</p> <p>Pasqyrë(plastike)</p> | <p>Shprehjet themelore/ nocione prekje orientim koka-sy, veshë, hunda, buzë, mjekra, dhëmbë flokë trupi- qafa, shpina, stomaku, duart- – shpatullat, bërryli, duart, gishtërinj këmbë- gjunjë,shputat gishtat e këmbës</p> <p>Hulumtimi shkencor sheh qëllon(para sheh) krahason</p> |
|--|--|---|---|

| Qëllimet e mësimit | Aktivitetet | Resurse(mjete dhe materiale) | Koncepte |
|---|--|---|---|
| Biologji (njerëzit dhe qeniet e gjalla) | | | |
| <p>Java 3 Njeh dhe emëron pjesë kryesore të jashtme të trupit.</p> <p>Hulumtimi shkencor Fakte dhe ideja Përpiqet të përgjigjet me mbledhje të fakteve duke vëzhguar.</p> <p>Qasja dhe shikimi i fakteve Bën krahasime.</p> | <p>Pason diskutimi me gjithë klasën. Bisedohet për emra dhe numër të pjesëve të veçanta të kokës, p.sh sytë,, hunda etj. Vizato tabelë që ti tregoni këto rezultate. Shfrytëzoni dy kolona të emëruara si „pjesë të kokës“ dhe „numër“.</p> <p>Kërkoni nga secili nxënës të bëj vizatim nga koka e tij dhe shpatullave dhe ti shënoj pjesët. Sigurojuni list me fjalë të cilat duhet të përshkruajnë p.sh:</p> <p>Mjekra, veshë, sy, flokë, koka, buzët, hunda</p> <p>Është e mundshme që arsimtari ti përgatis fjalitë me anë të ngjitësve, ndërsa nxënësit ti presin dhe ti ngjisin në vendin përkatës në fotografimin e tyre.</p> <p><u>Ora 5: Emërimi i pjesëve të trupit(2)</u></p> <p>Këndoni këngën në të cilën ceken pjesët e trupit.</p> <p>Kërkoni nga nxënësit të lëvizin pjesë të ndryshme të trupit p.sh shpatullat- i ngini ose i ulni – edhe pse është e detyrueshme ta tregojnë atë.</p> <p>Nxënësit shëtisin ose vrapojnë në hapësirat në mënyra të ndryshme p.sh ngadalë, shpejt, lehtë etj.</p> <p>Disa nxënës tregojnë mënyra të ndryshme të lëvizjes nga trupi i tyre . Nxënësit tjerë i shfrytëzojnë të njëjtat lëvizje.</p> | <p>Flip çart dhe markera ose letër e bardhë.</p> <p>Gërshërë Ngjitëse</p> <p>Hapësirë e mbyllur ose e hapur për të lëvizur. Vëreni se vallë nxënësit kanë mbathje të përshtatshme.</p> <p>Flip çart dhe markera ose tabelë e bardhë. gërshërë gomë për ngjitje</p> <p>letra të mëdhaja, markera të ngjitura</p> | <p>Karakteristika/dhe numri</p> <p>Gjatë sigurimit të listës me fjalë, hulumtimi tregon se për nxënësit është më lehtë të përdorin kur ato janë të renditura sipas alfabetit.</p> <p>Shprehje kryesore/nocione Si për njësinë 4 dhe . . . ngrenë shpatullat lëviz kopjon</p> |

| Qëllimet e mësimit | Aktivitetet | Resurse(mjete dhe materiale) | Koncepte |
|--|--|---|----------|
| Biologji (njerëzit dhe qeniet e gjalla) | | | |
| | <p>Arsimtari i pyet nxënësit të emërojnë pjesën e trupit me të cilën e realizon lëvizjen. Më pas arsimtari i inicon nxënësit ta identifikojnë shkronjën e parë ose zë nga fjala, ose të përpiqet të shqiptoj shkronjë pas shkronje.</p> <p>Bëjeni prerjen e këtyre fjalëve dhe me anë të ngjitëses i ngjitni në vendin e përshtatshëm. Në dysheme (pjesën e poshtme) të klasës vizatoni fëmijë (në letër të madhe). Kërkoni nga nxënësit të ngjisin fjalët në vendin përkatës.</p> <p>Secilit nxënës i jepni një kopje nga fleta e punës „Pjesët e mia të trupit“. Nxënësit duhet ti shënojnë fjalët me të cilat janë shënuar në vendet përkatëse për pjesët e trupit (mundet t'i kopjojnë fjalët ose ti presin dhe ti ngjisin ato).</p> | <p>Fleta e punës: „Pjesët e mia të trupit“, e tregojnë konstruktin e trupit dhe janë dhënë fjalët për pjesët e trupit, të jenë të mëdha mjaftueshëm që mund ti presin nëse ajo është e nevojshme.</p> | |

| | | | |
|--|--|---|--|
| <p><u>Java e 3</u> Hulumtim se si shqisat u mundësojnë njerëzve dhe qenieve të tjera të gjalla të jenë të ndërgjegjshme më botë rreth tyre.</p> <p><u>Hulumtimi shkencor</u> Planifikim për punë hulumtuese Parashtrim të pyetjes dhe pjesëmarrje në diskutim që të vijë deri te përgjigja.</p> <p>Fitimi dhe paraqitja e fakteve Hulumtim, vëzhgim dhe mbledhje të fakteve (matje dhe hulumtim) për tu përgjigjur në pyetjet.</p> | <p><u>Ora 6 Shqisa</u> Kërkoni nga nxënësit ta shtrëngojnë lëkurën në pjesën e sipërme të dorës së tyre dhe ta përshkruajnë se çfarë ndjejnë.</p> <p>Përdoreni thjerrëzën për të parë në sipërfaqen e lëkurës. Bisedoni për atë se çfarë bën lëkura jonë për ne- jep mbrojtje, nuk lëshon ujë etj.</p> <p>U jepni pasqyrë nxënësve ti shohin sytë e tyre . Bisedoni për atë se çfarë mund të bëni nëse ju hyn në sy. Çfarë sytë tona na ndihmojnë të bëjmë?(të shohim). Tregoni se mbajtja e syzave e përmirëson shikimin.</p> <p>Në çifte, shiheni në mes veti në veshë. Bisedoni për atë se çfarë bëjnë veshët tona – na ndihmojnë të dëgjojmë. Bisedoni për rrezikun për mbajtjen e objekteve në veshët tona.</p> <p>Bisedoni për aromën që ju pëlqen ose nuk ju pëlqen.</p> <p>Me ndihmën e pasqyrës nxënësit e shohin gjuhën e tyre. Tregojnë se çfarë vërejtën dhe se për çfarë shërben gjuha. Bisedohet edhe për atë se pse mjekët kërkojnë ta shohin gjuhën kur jemi të sëmurë.</p> | <p>Thjerrëz</p> <p>Pasqyrë (plastike) Nëse bëhet prej qelqi duhet të jetë e mbrojtur në pjesët e jashtme me trak izoluese për mbrojtje nga prerja</p> | <p>Shprehjet themelore/ nocione Shqisa – pamje/ shikim, prekje/ ndjenjë. Aromë, dëgjim.</p> <p>Hulumtim shkencor Sheh Krahason</p> |
|--|--|---|--|

| Qëllimet e mësimit | Aktivitetet | Resurse(mjete dhe materiale) | Koncepte |
|---|--|--|--|
| Biologji (njerëzit dhe qeniet e gjalla) | | | |
| <p><u>Java e 4</u> Hulumtim se si shqisat u mundësojnë njerëzve dhe qenieve të tjera të gjalla të jenë të ndërgjegjshme më botë rreth tyre.</p> <p>Planifikim për punë hulumtuese Parashtrim të pyetjes dhe pjesëmarrje në diskutim që të vijë deri te përgjigja.</p> <p>Fitimi dhe paraqitja e fakteve Hulumtim, vëzhgim dhe mbledhje të fakteve (matje dhe hulumtim) për tu përgjigjur në pyetjet.</p> | <p>Lojë- pantonima: mësimmhdhënësi bën ndonjë lëvizje dhe kërkon nga nxënësit të njohin se çfarë bën dhe cilën shqisë e shfrytëzon.</p> <p>Me ndihmën e lojës arsimtari e përshkruan shqisën (na ndihmon ta njohim botën rreth nesh). Çojeni fjalën me organin e shqisë gjë që ka rëndësi të veçantë.</p> <p>Përgatitni fleta pune për nxënësit që të bëjnë lidhjen e fotografive nga shqisat me shqisa të përshtatshme.</p> <p><u>Ora e 7: Mundem të prek</u> Luaje lojën me 20 pyetje: Tregojuni nxënësve se kanë një objekt në qese dhe detyra e tyre është të qëllojnë se çfarë është ajo. Thojuni se ato mund të parashtrajnë 20 pyetje dhe se ju mund tu përgjigjeni vetëm me „po“ ose „jo“. Sa më shpejt ato mund ta qëllojnë se çfarë ka në qese? Tregojuni objektin kur ta qëllojnë saktë por edhe pas 20 pyetjeve. Përsëriteni lojën disa herë.</p> <p>Më pas luteni disa nxënës të dalin para dhe të bëjnë identifikimin e objekteve të cilat janë vendosur në kесе (qese e butë) e përshtatshme për prekje. Përsëritni lojën disa herë. Shënoni fjalët (në tabelë ose flip çart) të cilat përdoren për ta përshkruar objektin para ose pasi të bëhet identifikimi.</p> <p>Në çifte, mbuloni sytë (lidheni me shami) dhe duke u ndërruar me partnerin të bëni identifikimin e objekteve në klasë thjesht me prekje..</p> | <p>Fletë pune: Shqisat e mija</p> <p>http://en.wikipedia.org/wiki/Twenty_Questions</p> <p>Qese prej mëndafshi (do të ishte mirë sikur në pjesën e sipërme ka lidhëse) zgjedhje e objekteve që do të jenë lehtë për tu identifikuar me prekje, p.sh. monedhë, kapse, laps, gurë, lojëra fëmijësh etj...</p> <p>Flip çart dhe markera ose tabel të bardhë</p> <p>Mbulesë për sytë-shami. Zgjedhje e objekteve të përditshme nga shkolla p.sh furçë për lyerje, libër, vizore, bimë</p> <p>Flip çart dhe markera ose tabelë të bardhë</p> | <p>Shprehjet themelore/ nocione Prekën/ndjen Objekt/send Qese mëndafshi Qese përshkruan</p> <p>Hulumtim shkencor Sheh Pyet</p> <p>Vëreni vallë nxënësi pa pengesa do të mbante mbulesë për sytë, dikush mund të frikohet nga ajo, ve theks të veçantë ato që e kanë frikë errësirën.</p> |

| Qëllimet e mësimit | Aktivitetet | Resurse(mjete dhe materiale) | Koncepte |
|--|---|--|--|
| Biologji (njerëzit dhe qeniet e gjalla) | | | |
| | <p>Kërkoni nga nxënësit ti vizatojnë objektet të cilat i identifikojnë dhe të njëjtat ti përshkruajnë me ndihmën e fjalive të cilat janë përdorë gjatë orës mësimore. Më pas mund ta përdorni listën e flip çartit / tabelën ose jepuni listë me fjalë të cilat do të mund ti përshkruajnë. Duke ju dhënë kurajë nxënësve që të „përpiqen“ ti shënojnë ato.</p> <p>Bisedoni se cilët objekte ishin të lehta për tu identifikuar dhe pse.</p> <p>Keni parasysh se secili nxënës din se mund ti përdori gishtërinjtë e tij për prekje.</p> | | |
| <p><u>Java e 4</u> Hulumtim se si shqisat u mundësojnë njerëzve dhe qenieve të tjera të gjalla të jenë të ndërgjegjshme më botë rreth tyre.</p> <p><u>Hulumtimi shkencor</u> Planifikim për punë hulumtuese Paraqet ide dhe i ndjek udhëzimet.</p> <p>Qasja dhe shikimi i fakteve Krijon ide dhe diskuton për ato me qëllim që ti shpërndaj , sqaroj dhe zhvilloj.</p> | <p><u>Ora 8:Mundem të shoh</u> Në tabelë shënoni ose projekttoni tekst me shkronja të mëdha të nxjerra nga ndonjë këngë e njohur ose përrallë. Së bashku me nxënësit lexoni e më pas jepuni guxim që të gjithë së bashku të kyçen. Më pas kërkoni nga nxënësit ta mbyllin njëri sy dhe përsëri ta lexojnë. Çfarë ndodh ? A ka ndryshim?</p> <p>Tregojuni nxënësve tabelë optike sikurse tabela që e përdor okulisti(mjeku u syve). Sa shkronja ato mund të lexojnë ose të shohin me dy sy ? Nga interneti merrni tabelën e syve. →</p> <p>Përgatitni materiale për aktivitete të ndryshme interesante: 1. Vizatoni se çfarë shikoni në thellësinë e lugës metalike. Krahasoni me vizatimin e asaj që do ta shihni në bishtin e lugës metalike.</p> | <p>Libër i madh ose libër me paraqitje dhe grafoskop.</p> <p>Tabela e syve për okulistët http://www.i-see.org/block_letter_eye_chart.pdf</p> <p>Lugë metalike – e mjaftueshme nga 1 lugë për secilin lapsa</p> | <p>Shprehjet themelore/ nocione Shih/pamje sy iluzione optike</p> <p>Hulumtime shkencore Sheh Krahason</p> |

| Qëllimet e mësimit | Aktivitetet | Resurse(mjete dhe materiale) | Koncepte |
|---|--|---|--|
| Biologji (njerëzit dhe qeniet e gjalla) | | | |
| | <p>2. Përgatitni kartele me madhësinë e kartolinave me pikë në mes të anës e djathtë në margjinat dhe shënojeni me X në qendrën e anës së djathtë. Drejtoni nxënësit ta mbyllin syrin e majtë dhe ta afrojnë kartolinën më afër nga syri. Gjithë kohën e shohin pikën me syrin e djathtë. Çfarë ndodhë?</p> <p>3. Ju jepni disa iluzione optike- përpiqeni me patën ose lepurin ?. Qiriun ose vazon?, nga kjo ueb faqe.</p> <p>Thirrni një vullnetar tju vendos një mbulesë në sytë dhe kështu ta kaloni rrugën me ndihmën e shkopit ndihmës. Shfrytëzoni lojëra që të mund ti nënvizoni kufijtë e rrugës.</p> <p>Përfundim: Sytë tonë janë të rëndësishëm pasi ato na mundësojnë të shohim.</p> | <p>Letër për vizatim kartolina</p> <p>të përgatitura</p> <p>http://www.sciencekids.co.nz/pictures/illusions.html</p> <p>Mbulesë të butë për sytë, lojëra, shkopi për persona që nuk shohin ose shkop nga prej një metri.</p> | |
| <p>Java e 5</p> <p>Hulumtim se si shqisat u mundësojnë njerëzve dhe qenieve të tjera të gjalla të jenë të ndërgjegjshme më botë rreth tyre.</p> <p>Hulumtim shkencor</p> <p>Ide dhe fakte</p> <p>Përpiqet të përgjigjet në pyetjet për mbledhjen e fakteve nëpër mjet të vëzhgimit.</p> <p>Fitim dhe paramendim të fakteve</p> <p>Hulumtim, vëzhgim dhe mbledhje faktesh (matje dhe vëzhgim) për t'ju përgjigjur pyetjes.</p> | <p>Ora e 9: Mund të dëgjoni</p> <p>Mbylleni sytë për një minutë dhe përpiquni që të mbani mend të gjitha zërat që i dëgjoni. Bisedoni për zërat që i dëgjoni.</p> <p>Lusni nxënësit t'i vendosin duart /pëllëmbët te veshët e tyre . Tregoni ndonjë këngë të njohur ose vjershë-ato vallë a do të ju njohin se çfarë flisni?</p> <p>Në çifte, luani lojën disa herë me partnerin tuaj.</p> <p>Dilni jashtë dhe gjeni ndonjë vend të qetë për tu ulur. Shfrytëzoni letër dhe laps që ta dëgjoni secilin zë. Jepni sinjalin (duke fishkëlluar ose i rënë ziles që ta dëgjoni fillimin dhe mbarimin e secilit zëri.</p> | <p>Hapësirë e hapur laps.</p> <p>Letër ose kartolinë, bilbil,ose zile</p> | <p>Shprehjet themelore/ nocione</p> <p>Dëgjon/dëgjim</p> <p>Hulumtim shkencor</p> <p>shoh</p> <p>vëren</p> <p>MOS përdorni shënori ose vizatoni për këtë aktivitet , shfrytëzoni zërin „incizo/vërej“ në udhëzuesin që tua mundësoni nxënësve zgjedhje të ndryshme.</p> <p>Nxënësit do të din ta njohin veprën e tyre edhe nëse nuk është e emëruar.</p> |

| Qëllimet e mësimit | Aktivitetet | Resurse(mjete dhe materiale) | Koncepte |
|--|--|---|---|
| Biologji (njerëzit dhe qeniet e gjalla) | | | |
| | <p>Kthehuni në shkollë dhe kërkoni nga nxënësit të përshkruajnë gjithë çka që kanë dëgjuar dhe evidentuar.</p> <p>Bëni turba për veshë, Përdorni gota plastike ose gota prej letre. Bëni vrima në pjesën e poshtme të gotave . Secilit nxënës jepni nga një çift trumbe për vesh Mbani gotat te veshët. Lëshoni muzikë dhe kthehuni nga aparati muzikor dhe më pas largohuni nga ai. Çfarë do të ndodhë?</p> | <p>gërshërë gota letre ose plastike muzikë dhe instrument muzikor</p> | <p>Zëri është më i fortë kur gotat janë kthyer nga zëri. Gota e orienton zërin nga veshi.</p> |
| <p>Java e 5 Hulumtim se si shqisat u mundësojnë njerëzve dhe qenieve të tjera të gjalla të jenë të ndërgjegjshme më botë rreth tyre.</p> <p>Hulumtimi shkencor Fitimin dhe para e fakteve Hulumtim, vëzhgim dhe mbledhje faktesh (matje dhe vëzhgim) për tu përgjigjur pyetjes.</p> <p>Qasje dhe shikim të fakteve Krijon ide dhe diskuton për ato me qëllim që ti shpërndaj . sqaroj dhe zhvilloj.</p> | <p><u>Ora10: Mund të shioj</u> Bisedoni për atë se cilën e kanë nxënësit ushqimin e preferuar. Shënoni listë të ushqimeve të preferuara.</p> <p>Bisedoni për ushqimet që ato nuk kanë dëshirë ti hanë.</p> <p>Sillni disa produkte ushqimore për ti provuar – zgjidhni të cilat ndoshta nuk i kanë provuar më herët, nëse është e mundshme.</p> <p>Shfrytëzoni pasqyrën që ta shohin gjuhën e tyre . Tregojuni se si mundemi ti vërejmë katër shijet – e ëmbël, e thartë, e gjelbër, e ithët.</p> <p>Përgatitni lloje të ndryshme të ushqimit për kureshtje. Identifikoni shijet e ndryshme të secilit artikull ushqimor. Sigurojeni ujë për pije për nxënësit – të pini pas çdo testimi të shijes.</p> | <p>Flip çart dhe markera ose tabelë të bardhë</p> <p>Pasqyrë(plastike). Nëse janë ndërtuar nga qelqi të njejtat duhet siguruar në pjesët e jashtme me brojtëse për tu mbrojtur.</p> | <p>Të jeni të vetëdijshëm për të gjitha alergjitë ose jotoleranca e ushqimit ose artikujt ushqimor të ndaluara për disa nxënës.</p> <p>Shprehjet themelore/ nocione Ushqimi i preferuar Shije/ gjuhë qelq e njelmët e thartë e ithët</p> <p>Hulumtime shkencore Sheh Evidenton Tregon</p> <p>Sigurohuni se vallë i keni duart e pastra para se ta shfrytëzoni dhe shijoni ushqimin.</p> |

| Qëllimet e mësimit | Aktivitetet | Resurse(mjete dhe materiale) | Koncepte |
|--|---|--|--|
| Biologji (njerëzit dhe qeniet e gjalla) | | | |
| | Nxënësit shijojnë produkte ushqimore duke i parë me sy. Pason diskutimi mbi atë se a ka dallim kur ushqimi bëhet provë kur i keni sytë e mbyllura ose kur mund të shohim ushqimin | Fleta pune me hapësirë të pastër për të shënuar vërejtjet për ushqimin dhe shijen. | |
| <p>Java e 6 Hulumtim se si shqisat u mundësojnë njerëzve dhe qenieve të tjera të gjalla të jenë të ndërgjegjshme më botë rreth tyre.</p> <p>Hulumtimi shkencor Fitimin dhe para e fakteve Hulumtim, vëzhgim dhe mbledhje faktesh (matje dhe vëzhgim) për tu përgjigjur pyetjes.</p> <p>Qasje dhe shikim të fakteve Krijon ide dhe diskuton për ato me qëllim që ti shpërndaj . sqaroj dhe zhvilloj.</p> | <p>Ora11: Mund të armojë Tregojuni nxënësve disa produkte me shije të mira dhe bisedoni se si i identifikojnë të njëjtat (nëpër mjet të aromës) Më pas një numër i nxënësve le të identifikojnë produkte ushqimore dhe aroma të ndryshme.</p> <p>Bisedoni për aromat të cilat nuk ju pëlqejnë. Shënoni list të ushqimeve që ju pëlqejnë/ që nuk ju pëlqejnë. Përgatitni disa enë të evidentuara me numra, secili të përmbaj aromë të ndryshme. Nxënësit duhet të zbulojnë se çfarë ka në secilën pjatë vetëm nëpër mjet të aromës.</p> <p>Bisedoni mbi atë se se kur është e dobishme të merret erë nga ushqimi jo i mirë p.sh buka e thartuar. Qumështi i thartuar, rrushi i prishur etj.</p> <p>Përfundim: Mund të marr erë pasi që e shfrytëzoj hundën / hunda ime më jep mundësin të marrë erë / aromën.</p> | Lapsa Letër ose fletore | <p>Të jeni të vetëdijshëm për të gjitha alergjitë e nxënësve – me theks të veçantë substancat kimike dhe sintetike</p> <p>Shprehjet themelore/ nocione aromë mykje e thartë</p> <p>Hulumtim shkencor sheh tregon identifikon</p> <p>Tregojuni që të mos largojnë as një kapak nga enët (edhe pse substancat duhet të jenë të sigurta!)</p> |

Njësia :1.2 Prej çfarë është bërë?

Në këtë temë nxënësit mësojnë për karakteristikat dhe përdorimin e materialeve të njohura të ndryshme. Ato njihen me fjalorin shkencor i cili përdoret për përshkrim dhe krahasim të materialit.

| Qëllimet e mësimit | Nocione |
|---|---|
| <p>Mendime dhe fakte - përpiqet të përgjigjet në pyetjet duke mbledhur fakte gjatë vëzhgimit</p> <p>Planifikimi për punë në hulumtim - parashtrim të pyetjeve dhe pjesëmarrje në diskutim që të vjen deri te përgjigja - parashikimi - vendos se çfarë të bëjë për tu përgjigjur në pyetjen shkencore.</p> <p>Fitim dhe parashikim të fakteve - hulumtim, vëzhgim dhe mbledhje të fakteve (matje dhe vëzhgim) për tu përgjigjur në pyetjen - propozon ide dhe i ndjek udhëzimet - evidenton fazat e punës</p> <p>Qasje dhe parashikim të fakteve - bën krahasime - krahason parashikime me rezultatet e fituara - ndërton ide dhe diskuton për ato me qëllim të shpërndaj, sqaroj dhe zhvilloj.</p> | <p>Materiale p.sh.: dru letër qelq plastik metal (dhe të gjitha materialet tjera relevante që janë paraqitur)</p> <p>Hulumtime shkencore pyet sheh zgjedh zbulon tregon tregon shkruan flet vizaton krahason qëllon (parasheh) shpërndan</p> |

| Qëllimet e mësimit | Aktivitetet | Resurse(mjete dhe materiale) | Koncepte |
|---|---|---|---|
| Kimi(Përbërja e materialeve) | | | |
| <p>Java e 6 Shfrytëzon shqisat për të hulumtuar dhe diskutoj për materiale të ndryshme .</p> <p>Hulumtime shkencore Mendime dhe fakte Përpiqet të përgjigjet në pyetjet me mbledhjen e fakteve nëpër mjet të vëzhgimit</p> <p>Planifikim për hulumtim të punës Parashtron pyetje dhe merr pjesë në diskutime për të ardhur deri te përgjigja.</p> | <p>Ora 12: Kërkim të materialeve në shkollë</p> <p>Pyeti nxënësit të emërojnë diçka/ ndonjë mjetë në klasë dhe të tregojnë se prej çfarë është ndërtuar.</p> <p>Bëni renditje/përsëritje të kujtesës. Diskutoni për atë se si kujtesa jonë na ndihmon të identifikojmë materiale të ndryshme.</p> <p>Në çifte, nxënësit duhet të gjejnë materiale nëpër klasë, p.sh të gjalla/ asnjëherë nuk kanë qenë të gjalla / të ngurta/ të buta/yndyrore/ të ashpra etj. Pyeteni ato rreth qasjes me pyetjen: „Si e din se çfarë është kjo?“</p> <p>Tregoni se ku nxënësit mund ti sjellin materialet për ti vendosur rreth simboleve të përshtatshme: të ashpra/të forta/të lëmuara.</p> <p>Luajeni lojën: „Ma sill...“ Kërkoni nga nxënësit që t’ju sjellin material të caktuar, p.sh: i ashpër/i lëmuar/:</p> | <p>zgjedhje të materialeve të përditshme nëpër klasë, me forma dhe përbërje të ndryshueshme dhe të tjera të ngjashme... p.sh vizore prej druri, bimë, lugë metali, foli alumini, gurë, tekstil, lojëra plastike etj.</p> <p>etiketa</p> | <p>Shprehje kryesore/nocione Materiale p.sh: dru letër qelq plastikë metal (dhe të gjitha materialet relevante me të cilat do të njoftohen) të gjalla asnjëherë nuk kanë qenë të gjalla të ngurta të buta të lëmuara të ashpra të ndritura prekje erë shih dëgjo shijo kujtesë</p> <p>Hulumtime shkencore sheh zgjedh tregon shënon tregon/përshkruan</p> <p>Këto grupe mund të zgjerohen për ti njohur materialet natyrore dhe artificiale</p> |

| Qëllimet e mësimimit | Aktivitetet | Resurse(mjete dhe materiale) | Koncepte |
|---|--|--|--|
| Kimi(Përbërja e materialeve) | | | |
| <p>Java e 7</p> <p>Shfrytëzoje kujtesën për hulumtim dhe diskutim për materialet e ndryshme.</p> <p>Hulumtim shkencor Mendime dhe fakte Përpiqet të përgjigjet në pyetjet me mbledhjen e fakteve duke vëzhguar.</p> <p>Fitimi dhe paraqitja e fakteve Hulumtim, vëzhgim dhe mbledhja e fakteve(matja dhe vëzhgimi) që të përgjigjet në pyetjet.</p> | <p>Ora 13: Kërkim të materialeve jashtë klasës</p> <p>Përsëri luaje lojën „Ma sill...“ nga njësia e mëparshme.</p> <p>Bisedo për objektet e reja që do ti sjellin nxënësit.</p> <p>Dilni jashtë në një hapësirë të definuar qartë . Tregoni nxënësve se si duhet përdorur aparati për mbledhjen e insekteve. Mblidhni fakte ose fotografoni.</p> <p>Vëreni qasjet në fletën e punës; p.sh. emëroi (ose vizatoi) ato të cilat i keni vërtetuar se: nuk janë të gjalla/ të gjelbra/ natyrale/ të dukshme/ ujë rezistuese.</p> <p>Bisedoni për punët që i keni gjetur jashtë ne krahasim me ato te cilat ndodhen në klasë nga ora e mëparshme.</p> | <p>Mjete ose materiale nga klasa në hapësirë te hapur. Mjeti për kapjen e insekteve në ueb faqen e shënuar si ta bëni për vete:http://www.amentsoc.org/bug-club/fun/experiment-pooter.html</p> <p>http://www.amentsoc.org/bug-club/fun/experiment-pooter.html</p> <p>kamerë digjitale</p> <p>fletë pune laps</p> | <p>Shprehje kyçe/nocione</p> <p>Materiale p.sh: dru, letër, qelq, plastik. metal</p> <p>Hulumtim shkencor pyet sheh tregon shkruan tregon/sqaron vizaton qëllon(parasheh) shkëmben Enët për mbledhjen e insekteve funksionojnë kur në njërin skaj të gypit e vendosim në insektin dhe me ndjellje insekti do të futet në enën tjetër, zakonisht në kapakun kemi llupë, më pas kapaku i enës mund të lirohet dhe insekti në formë të sigurt mundtë zhvendoset në ambientin ku jeton. Jepni kurajë që të mos mbledhin gjallesa ose lule, dhe gjithçka që të mbledhin ta kthejnë ose ta ndërrojnë me gjendjen e mëparshme që e kanë gjetur.</p> |

| Qëllimet e mësimit | Aktivitetet | Resurse(mjete dhe materiale) | Koncepte |
|---|--|--|--|
| Kimi(Përbërja e materialeve) | | | |
| <p><u>Java e 7</u> Shfrytëzoje kujtesën për hulumtim dhe diskutim për materialet e ndryshme.</p> <p><u>Hulumtim shkencor</u></p> <p>Mendime dhe fakte Përpiqet të përgjigjet në pyetjet me mbledhjen e fakteve duke vëzhguar.</p> <p>Fitimi dhe paraqitja e fakteve Propozon ide dhe i ndjek udhëzimet.</p> | <p><u>Ora 14: Hulumtim i materialeve</u></p> <p>Përsëri bisedoni për shqisat dhe cila prej tyre na ndihmon gjatë identifikimit të materialit- duke shikuar dhe prekur, nganjëherë edhe aromës, shijes dhe dëgjimit. Pyeteni tju tregojnë se për se na shërbejnë secila shqisë veçmas.</p> <p>Zgjedhni një mjetë i cili mund të përshkruhet duke e përshkruar me të gjitha shqisat. Bisedo me nxënësit : „Si duket ajo / si dëgjohet/ çfarë arome? Gjithashtu pyeteni a është e sigurt që ajo të provohet? Tregoni nxënësve se si ti nënvizojnë përshtypjet e tyre në tabelë</p> <p>Më pas secili nxënës merë fletë pune në të cilën i shënojnë të gjitha përshtypjet për secilin mjetë. Në kolonën e parë të fletës punuese shënohet mjeti dhe vizatohet . Në kolonat tjera shënohet se si duket , çfarë arome ka, shije, zë. Më pas nxënësit marrin guximin të shfrytëzojnë fjali të ndryshme për dukurit që vërejnë.</p> <p>Tregojuni nxënësve grupe materialesh prej të cilave janë ndërtuar mjetet. Parashtroni të njëjtat pyetje</p> | <p>Zgjedhje e mjeteve të përditshme</p> <p>Flipçart dhe markera ose tabelë të bardhë</p> <p>Flet pune lapsa</p> <p>bloqe nga materialet: dru/plastike/qelqi/metal etj.</p> | <p>Shprehjekryesore/nocione Materiale p.sh: dru, letër qelq plastikë metal (dhe cilin do material i cili vendoset)</p> <p>Hulumtime shkencore sheh zgjedh njoftohet tregon shënon flet/tregon vizaton krahason përshkruan</p> <p>Ato gjithashtu mund t'i krahasojnë materialet e ngjashme që mund ti gjejnë.</p> |

| Qëllimet e mësimit | Aktivitetet | Resurse(mjete dhe materiale) | Koncepte |
|--|---|--|---|
| Kimi(Përbërja e materialeve) | | | |
| <p>Java e 8 Identifikon karakteristika të ndryshme të materialeve .</p> <p>Hulumtime shkencore Fitimin dhe paramendimin e fakteve Evidentoni fazat e punës. Parashikimin e fakteve dhe qasjeve Krijon ide dhe diskuton për ato me qëllim ti shpërndaj , sqaroj dhe zhvilloj.</p> | <p>Ora 15: Si duken materialet? Edhe një herë tregoni llojet e materialeve dhe pyeteni se prej se janë ndërtuara ato.</p> <p>Luteni nxënësit t'ju sjellin mjete të ndërtuara nga materiali i njëjtë.</p> <p>Vendosni materialet dhe objektet njërin karshi tjetrit për krahasim. Pyeteni nxënësit që ti emërojnë disa nga materialet. Bisedoni për karakteristika e materialeve të vendosura(shfaqura).</p> <p>Aktiviteti- zgjidhni dhe përshkruani karakteristikat e materialeve të ndryshme. E gjithë klasa, së bashku zgjedhin një shembull. Nxënësit mbushin fletën e punës. Në kolonën e parë e shënojnë materialin(dru, qelq, metal, gurë), më pas e shënojnë ngjyrën, gjendjen agregate, ashpërsinë/të lëmuarit, fortësinë. Më pas përshkruajnë dhe materiale të tjera.</p> <p>Pyeteni që t'ju tregojnë se çfarë është E ndritshme/ lëmuar /e rëndë etj.</p> | <p>Grupe materialesh</p> <p>Zgjedhje e mjeteve të përditshme</p> <p>Fipçart dhe markera ose tabelë të bardhë</p> | <p>Shprehje kryesore/nocione Materiale p.sh: dru, letër qelq plastikë metal (dhe cilin do material i cili vendoset)</p> <p>Hulumtime shkencore sheh zgjedh njoftohet tregon shënon flet/tregon vizaton krahason përshkruan</p> <p>Sqaroni se të gjitha objektet janë ndërtuara prej ndonjë materiali dhe se mund t'i përshkruajmë karakteristikat dalluese vetëm duke i parë.</p> <p>Krijoi fletë pune i cili do të plotësohet duke i futur me \surd ose x për deri sa nxënësit nuk janë të sigurtë në të shënuar.</p> |

| Qëllimet e mësimit | Aktivitetet | Resurse(mjete dhe materiale) | Koncepte |
